



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:047348

Datë: 30.07.2024

Numri i dokumentit: 05999114

KPPP.nr.295/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përbarimore të kreditorit “Media Marketing” SH.A., me NUI: 810517584, me seli në Prishtinë, Veternik, kundër debitorit “Luli” SH.P.K., me NUI: 811314682, me seli në Prishtinë, Tregu me shumicë të Amortizatorët, përfaqësuar sipas autorizimit nga Rrezon Hoxha, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.02/2024 të datës 04.01.2024, të Përbaruesit Privat Fadil I. Hoxha, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datës 30.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Luli” SH.P.K., i ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.02/2024 të datës 04.01.2024, të Përbaruesit Privat Fadil I. Hoxha.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përbarimor P.nr.02/2024 i datës 04.01.2024, i Përbaruesit Privat Fadil I. Hoxha.
- III. URDHËROHET debitori “Luli” SH.P.K., që në rast të parashtrimit ankesës, të deponoj në llogari të veçantë të “Këshillit Gjyqësor të Kosovës” nëpërmjet arkës së Gjykatës Themelore në Prishtinë, garancionin në shumën prej 5,000.00 € (pesë mijë euro), në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.
- IV. Nëse debitori nuk e deponon garancionin brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi, do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.

A r s y e t i m

Përmbaresi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Media Marketing” SH.A., ka lëshuar urdhrin përmbarimor P.nr.02/2024 të datës 04.01.2024, me të cilin e ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr.24062022/46 të datës 24.06.2022; 24.06.2022; Faturës Nr.24052022/73 të datës 24.05.2022; Faturës Nr. 26042022/27 të datës 26.04.2022; Faturës Nr.24032022/16 të datës 24.03.2022; Faturës Nr.24022022/10 të datës 24.02.2022; Faturës Nr.24012022/04 të datës 24.01.2022; Faturës Nr.24122021/82 të datës 24.12.2021; Faturës Nr.25.11.2021/77 të datës 25.11.2021; Faturës Nr.25102021/71 të datës 25.10.2021; Faturës Nr.24092021/63 të datës 24.09.2021 dhe Faturës Nr.26082021/57 të datës 26.08.2021, me të cilin ka detyruar debitorin që kreditorit t’ia paguaj borxhin në shumën prej 5,000.00 €, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore dhe ato të përfaqësimit, ashtu që të bllokohen të gjitha llogaritë bankare pranë të gjitha bankave, po ashtu dhe me regjistrimin, konfiskimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të debitorit deri në arritjen e borxhit në tërësi si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor duke theksuar se dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri përmbarimor nuk ka tiparet e dokumentit të besueshëm për shkak se në të nuk është cekur data e pagesës, mbi bazën e të cilës do të dëshmohej se kur është bërë e kërkueshme kredia, andaj faturat në këtë rast nuk i plotësojnë kushtet ligjore nga neni 29 dhe 37 i LPP-së. Tutje ka shtuar se për tu iniciuar procedura përmbarimore nuk mjafton vetëm të ketë fatura, por të njëjtat duhet të kenë një mbështetje në ndonjë dokument apo marrëveshje mes palëve. I ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin e debitorit, ta anuloj urdhrin përmbarimor, si dhe ta detyroj kreditorin që debitorit t’ia kompensoj shpenzimet e përpilimi të prapësimit sipas TOA.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit, duke theksuar se së bashku me propozimin për përmbarim janë bashkangjitur faturat në origjinal, të pranuar nga debitori si dhe të vulosura pa vërejtje nga ana e debitorit. Sa i përket pretendimit se nuk është cekur koha e pagesës së faturave ka theksuar se afati i pagesës së faturave ka qenë në të njëjtën ditë kur janë kryer shërbimet, dhe është lëshuar fatura. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbarimor ta lë në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigja në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, e duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të cilave është lejuar urdhri për përmbartim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”* dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm përkatësisht Faturën Nr.24062022/46 të datës 24.06.2022; 24.06.2022; Faturën Nr.24052022/73 të datës 24.05.2022; Faturën Nr. 26042022/27 të datës 26.04.2022; Faturën Nr.24032022/16 të datës 24.03.2022; Faturën Nr.24022022/10 të datës 24.02.2022; Faturën Nr.24012022/04 të datës 24.01.2022; Faturën Nr.24122021/82 të datës 24.12.2021; Faturën Nr.25.11.2021/77 të datës 25.11.2021; Faturën Nr.25102021/71 të datës 25.10.2021; Faturën Nr.24092021/63 të datës 24.09.2021 dhe Faturën Nr.26082021/57 të datës 26.08.2021, e cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par.3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i faturave, si dhe është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura, i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, gjë e cila vërtetohet nga nënshkrimi dhe vula e debitorit.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e tjera të debitorit në këtë procedurë, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbarimi.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata ka urdhëruar debitorin, në rast të parashtrimit të ankesës të deponoj garancinë në gjykatë, në shumën e përcaktuar si në këtë pikë të dispozitivit të këtij aktvendimi dhe gjykatës t'ia dorëzoj provën për pagesën e garancionit, konform dispozitës ligjore të nenit 78 par.2 dhe 4 të LPP-së.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.295/24, datë 30.07.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate